





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica S



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Raporti i punës për vitin 2025

Mars, 2026

Parathënje:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës përbëhet nga tre sektorë: Sektori i Kulturës, i Rinisë dhe i Sportit, që në fakt përbëjnë edhe kompleksitetin e punës së kësaj drejtorie. Institucionet vartëse të saj janë: Qendra e Kulturës, Teatri i Qytetit, Biblioteka Komunale “Latif Berisha”, Muzeu i Qytetit, Palestra e Sporteve “Minatori”, Galeria e Arteve. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës në vazhdimësi ka paraparë ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të saj në fusha të ndryshme. Në bashkëpunim me institucionet vartëse, ka planifikuar qëllimet dhe objektivat e saj për këtë vit, dhe, duke analizuar në hollësi buxhetin e planifikuar për këtë vit dhe duke pasur parasysh resurset njerëzore, ka planifikuar që gjatë këtij viti kalendarik të mbështesë në forma të ndryshme ngritjen e kapaciteteve në sektorët e saj, gjithmonë në bazë të ligjeve që rregullojnë punën institucionale dhe menaxhimit komunal. DKRS është përgjegjëse dhe aktive në punën e saj, në mënyrë që objektivat e parashikuara të arrihen dhe të respektohen aktivitetet tradicionale të sektorëve përkatës, të iniciojë bashkëpunime të reja dhe të nxisë investitorët të investojnë, si dhe të kërkojë fonde shtesë.

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë dhe përfshinë mbështetjen periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjëse për detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Hartimin e planit për mbështetjen kulturore, sportive dhe rinore;
2. Udhëheqje me resurset lokale kulturore, rinore dhe sportive;
3. Udhëheqje me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës, Palestrën e sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
4. Organizimin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
5. Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës, rinisë dhe sportit;

6. Grumbullimin e shënimeve faktike mbi të arriturat në kulturë, rini dhe sport;
7. Bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës dhe raportimin për punët e drejtorisë;
8. Bashkëpunim me nivelin qendror nga fushë veprimtaria përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;
9. Regjistrimin e grupeve, klubeve, ansambleve etj;
10. Mbështetje të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
11. Bashkëpunim me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ, e organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
12. Përkrahje dhe ndihmë asociacioneve, klubeve dhe shoqatave në aktivitetet e tyre;
13. Përkrahje, mbështetje dhe mbikqyrje të punës dhe funksionimit të Qendrës Rinore në përputhje me ligjin;
14. Të ofrojë institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente edhe veprimtari të tjera);
15. Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë;
16. Të organizojë anketa, seminare e trajnime të ndryshme, kyçje të të rinjve kosovarë në aktualitete rinore, evropiane e botërore;
17. Të ushtrojë edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

Sektori i Kulturës

1. Aktivitetet kulturore tradicionale

- Festa e 17 shkurtit
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës
- Kremtimi i festave tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i përvjetorëve të rëndësishëm, sipas kalendarit të përpiluar nga Sektori i Kulturës
- Kremtimi i festes së 28 Nëntorit

2. Projektet kapitale afatgjata

- Objekti i përhershëm i Bibliotekës Komunale
- Objekti i përhershëm i Muzeut të Qytetit (janë bërë investime të vogla ku edhe gjatë këtij viti parashihet të i ipet selia e përheshme dhe të fillojnë investimet kapitale)
- Renovimi i Qendrës së Kulturës është bërë edhe përrurimi i punimeve

Punët administrative

- Janë përpunuar 150 lëndë
- Pjesë e komisionit Raporti i Performancës komunale për vitin 2024
- Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2025
- Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore të Komunës
- Komisionit për vlerësimin e pasurisë jo-financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut
- Pjesë e komisionit për Investime kapitale
- Pjesë e komisionit për subvencione individuale

AKTIVITETET E SEKTORIT TË KULTURËS

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarëvajtjes së punëve në institucionet vartëse.
- Jemi duke punuar për formimin e komisionit për të hartuar planin ideor mbi renovimet e Muzeut të qytetit.
- Koncert me rastin e 17 shkurtit “Sheshi Adem Jashari”
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës
- Koncerti me rastin e 28 nëntorit
- Aktivitete kulturore të mbështetura nga Sektori i Kulturës
- Projekti “Promovimi i Artit dhe Kulturës përmes fëmijëve” Ojq “Shqipet e Vogla”
- Festivali “Mitrovica Guitar Days 2025” Ojq Kosova Ars
- Festivali i Komedisë “Mitrix Culture”
- Festivali “Green Fest” ojq 7 Arte
- Festivali “Boletini n’Plis të bardhë
- Projekti “Panair” Promovimi i ushqimit dhe veshjeve tradicionale Me dore në Zemër

- Projekti "Sheshi Festiv" Ad Libitum (ku gjatë muajit Korrik dhe muajit Gusht u zhvilluan mbi 30 netë koncerte dhe pjesë tjera festive për mërgimtarët, gjithashtu edhe në muajin dhjetor janë zhvilluar mbi 20 netë aktivitete festive në kuadër të festave të fund vitit si dhe është bërë derokirimi i një pjesë të sheshit)
- Sektori i Kulturës mbas mbështetjes së aktiviteteve kulturore ka arritur të ketë mbi **370** aktivitete kulturore.

Muzeu i qytetit

Puna Muzeale dhe Ekspozitat

Në vitin 2025, Muzeu i Mitrovicës ka realizuar një sërë iniciativash të suksesshme për të bërë muzeun një Muze Gjithëpërfshirës për ta realizuar vizionin si Muze i të Gjithëve. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (DKRS), Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), OJQ-të dhe partnerët lokalë, muzeu ka avancuar përfshirjen dhe qasjen për vizitorët e të gjitha grupmoshave dhe grupeve të marginalizuara, duke garantuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet muzeale dhe edukative.

Ky proces ka përfshirë risitimimin e ekspozitave të përhershme, pasurimin e narrativave shpjeguese muzeale dhe afrimin e vazhdueshëm të muzeut me komunitetin. Veçanërisht, janë zhvilluar aktivitete edukative gjithëpërfshirëse, duke përfshirë:

- **Grupi i Thurjes** – një aktivitet krijues dhe edukativ për të gjitha grupmoshat, duke rikthyer artin e thurjes tradicionale dhe duke bashkuar breza të ndryshëm.
- **Punëtori vizatimi për fëmijë** – aktivitet i dedikuar për nxënësit, për të nxitur kreativitetin dhe njohuritë mbi trashëgiminë kulturore.
- **Punëtori me argjile dhe fije tekstile** – për fëmijë dhe të rritur, organizuar në bashkëpunim me shkollat lokale, për të zhvilluar aftësi artistike dhe kreativitetin.
- **Program me të rinj nga komuniteti me Sindromën Down** – një hapësirë për përfshirje aktive dhe zhvillim të aftësive artistike për grupet me nevojë të veçanta.

- **Programi edukativ “Muzeu Lëvizës”** -- Muzeun dërgoi aktivitete arti tek fëmijët e fshatit Bare si dhe bashkëpunime të tjera me shkolla dhe qendra burimore lokale, duke përfshirë pjesëmarrës me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, muzeu ka realizuar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën muzeale, duke përfshirë rregullimin e hapësirave me lysterjen e sallave për të siguruar një prezantim më profesional të koleksioneve. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit të muzeut, duke e pozicionuar Muzeun e Mitrovicës si një institucion të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për promovimin e trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, si dhe duke përmirësuar përvojën kulturore të vizitorëve.

Në kuadër të vitit 2025, Muzeu i Mitrovicës ka përgatitur dhe mbajtur 6 ekspozita tematike, të cilat përfshinin kombinime të aktiviteteve edukative, punës me komunitetin dhe përfshirjes së grupeve të marginalizuara, duke e bërë muzeun një hapësirë të gjallë, arsimues dhe gjithëpërfshirës.

Ekspozitat e Muzeut të Mitrovicës:

1. Ekspozita fotografike “Mitrovica – Shekulli XX”

- Hapur më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve.

Prezantoi një koleksion fotosh si narrativë vizuale mbi transformimin e qytetit gjatë shekullit të XX, nga fondi i fototekës së Muzeut të Mitrovicës.

2. Ekspozita “TESTAMENT”

- Realizuar në bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” dhe Muzeun e Mitrovicës. Paraqiti identitetin, rezistencën dhe suksesin e

komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë me fotografi të Arben Llapashticës, të kuruara nga Eliza Hoxha.

3. “Një Jetë Në Gajtan” në Expo Osaka, Japoni

- Përfaqësim ndërkombëtar i Kosovës me mbështetjen e MKRS-së. Drejtoresha Nora Prekazi prezantoi disa veshje tradicionale nga fondi i muzeut, së bashku me videon dokumentuese të përgatitjes së gajtanit si dhe punëtoritë artizanale të Florina Vulës përballë publikut japonez. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të Pavilionit të Shtetit të Kosovës në Expo Osaka 2025.

4. Ekspozita arkeologjike “Mitrovica Neolitike”

- Rikonceptim i ekspozitës arkeologjike pas një pune dyvjeçare përgatitore. Kuruar nga arkeologët Kaltrina Igrishta dhe Lekë Shala në bashkëpunim me Muzeun e Mitrovicës. Ku u prezantua koleksioni i arkeologjisë me një qasje bashkëkohore dhe më atraktive për trashëgiminë neolitike të Mitrovicës. Mbështetur nga MKRS dhe DKRS.

5. Risistemimi i ekspozitës së fosileve

- Në bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra, u risistua koleksioni i fosileve dhe u plotësua me narrativa shpjeguese në gjuhën shqipe dhe latine.

6. Ekspozita “Mozaik – Praktika të Artit Komunitar”

- Përmbylli vitin 2025 duke prezantuar punime nga aktivitetet edukative, Grupi i Thurjes “Vegëza”, punëtoritë kreative me nxënës, aktivitetet me komunitetin dhe programin “Muzeu Lëvizës”. Ekspozita u realizua në bashkëpunim me Fondacionin “Dhemetra” dhe me përkrahje nga DKRS – Mitrovicë dhe MKRS.

Programi Edukativ i Muzeut të Mitrovicës

1.1 Panele Diskutimi me profesionist të fushës të organizuara nga Muzeu i Mitrovicës

1. Tryeza diskutimi për Isa Boletinin u zhvillua më 15 janar 2025 me panelistët Enis Kelmendi dhe Gazmend Boletini. Tema e diskutimit ishte jeta dhe vepra e Isa Boletinit, si dhe roli i tij në mbrojtjen e identitetit kombëtar. Aktiviteti u moderua nga drejtoresha Nora Prekazi dhe u shoqërua me himnin kombëtar, interpretuar nga kori i SHMLA "Tefta Tashko".
2. Promovimi virtual i ekspozitës "Një Ditë" u realizua në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë. Panelistët ishin Bekim Blakaj dhe mbijetuarit Bahrije Gërxhaliu dhe Arton Ademi. Tema e diskutimit fokusohej në kujtesën kolektive dhe rolin e muzeve në përballjen me të kaluarën, ndërsa aktiviteti u moderua nga drejtoresha Nora Prekazi.
3. Një panel profesional u zhvillua rreth ekspozitës "Një jetë në gajtan", me pjesëmarrjen e Dr. Drita Statovcit, Zanita Halimit dhe Nora Prekazit. Diskutimi u fokusua në funksionin e veshjeve tradicionale, rolin e punës së dorës dhe rëndësinë e muzeut si platformë dialogu.
4. Programi edukativ i ekspozitës "Një jetë në gajtan", më 18 prill 2025, përfshiu një tryezë diskutimi me koleksionin privat të Shashivar Begut. Tema ishte prezantimi i veshjeve tradicionale të burrave dhe grave, duke përfshirë historitë dhe simbolet e gjalla që ato mbajnë.
5. Gjatë Ditëve të Trashëgimisë Evropiane 2025, u organizua një diskutim me Prof. Ass. Dr. Valon Shkodra mbi trashëgiminë arkitektonike dhe prezantimin e librit "Trashëgimia Kulturore e Kosovës në Kartolina". Diskutimi fokusohej në monumentet e Mitrovicës dhe rikonceptimin e ish-shtëpisë së Armatës si Muze i Qytetit.
6. Promovimi i katalogut "101 Figurina Antropomorfe dhe Zoomorfe nga Neoliti i Mitrovicës" u realizua me panelistët Luan H. Gashi, Shafi Gashi, Rezarta Loxha

Vitaku dhe Nora Prekazi. Tema e diskutimit ishte arkeologjia e Neolitit të Mitrovicës dhe interpretimi i figurave antropomorfe dhe zoomorfe.

Pjesëmarrja në konferenca, takime dhe vizita studimore

Gjatë vitit 2025, stafi i Muzeut të Mitrovicës mori pjesë në një sërë vizitash, konferencash dhe takimesh studimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave, fuqizimin e bashkëpunimeve dhe avancimin e praktikave muzeale:

Vizita të brendshme dhe studimore:

- Vizita nga 30 pjesëtarë të FSK-së me mentorë nga Ushtria Turke.
- Vizita nga stafi i OSCE-së.
- Vizita studimore nga Prof. Dr. Harald Floss, Universiteti i Tübingenit, Gjermani.
- Vizita nga përfaqësues të muzeve dhe institucioneve kulturore vendore si: Drejtori i MKRS-së, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Instituti Albanologjik i Kosovës, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor, Instituti për Mbrojtje të Monumenteve etj.
- Vizita nga komuniteti i diasporës.
- Vizita konsultative në Muzeun e Pejës nga stafi i Muzeut të Mitrovicës.

Vizita dhe pjesëmarrje në institucione dhe ekspozita të ndryshme:

- Muzeu Çast, nga Fondacioni Jahjaga.
- Muzeu i Fëmijëve të Luftës, nga YIHR – Kosovë.
- Ekspozita “Gjon Mili 17: Ajo që ia thotë këngës...” në Galerinë Kombëtare të Kosovës.
- Vizita në Muzeun e Historisë në Osaka, Japoni.
- Vizita në Muzeun e Artit në Kyoto, Japoni.
- Vizitë studimore në Muzeun e Vushtrisë, për shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim profesional.
- Vizitë bashkë me Shefin e Kulturës, Arbër Hajra, në Muzeun e Pejës për të diskutuar rreth Statutit të Muzeut të Pejës.

1.2 Bashkëpunime studiues dhe me institucionet relevante dhe shoqërinë civile

Gjatë periudhës raportuese, Ardit Jashari, Erleta Sahiti dhe Shkurte Gashi kanë përfituar mbështetje profesionale, burime studimore dhe këshillim nga Muzeu i Mitrovicës, si dhe nga institucione dhe bashkëpunëtorë të tjerë relevantë, në funksion të realizimit të veprimtarive të tyre në përputhje me standardet profesionale.

Gjatë vitit 2025, Muzeu i Mitrovicës ka intensifikuar dhe forcuar bashkëpunimet me organizata të shoqërisë civile, muze dhe institucione kulturore vendore dhe ndërkombëtare. Këto bashkëpunime kanë kontribuar në realizimin e ekspozitave, dokumentimin dhe hulumtimin e objekteve muzeale, zhvillimin e programeve edukative, si dhe krijimin e mundësive për vizita studimore dhe iniciativa të përbashkëta ekspozuese.

Në këtë kuadër, janë realizuar bashkëpunimet si në vijim:

- Bashkëpunim me KnBuk Heritage, i cili, me përkrahje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), ka mbështetur Muzeun e Mitrovicës në realizimin e ekspozitës “Mitrovica Neolitike”.
- Bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra në kuadër të projektit dhe ekspozitës etnologjike “Një

jetë në gajtan”, i mbështetur nga MKRS. Projekti ka përfshirë punë studimore në bashkëpunim me etnologët Prof. Dr. Drita Statovci, Prof. Dr. Lumnije Kadriu, Prof. Dr. Zanita Halimi, si dhe kuratoren Nora Prekazi Hoti.

- Bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra në projektin “Trashëgimia në Fije: Dokumentim, Ruajtje dhe Program Edukativ”, i cili ka mbështetur drejtpërdrejt programin edukativ të Muzeut të Mitrovicës dhe proceset e punës arkivore.
- Fillimi i bashkëpunimit me Muzeun Etnografik të Qytetit Istra në Kroaci, në kuadër të të cilit drejtoresha Nora Prekazi ka identifikuar 680 objekte etnologjike nga veshjet e Kosovës. Ky bashkëpunim pritet të zhvillohet më tej përmes një vizite studimore dhe të krijojë mundësi për realizimin e një ekspozite të përbashkët.

Ky rrjet bashkëpunimesh ka kontribuar në avancimin e rolit të Muzeut të Mitrovicës si institucion i hapur për bashkëpunim profesional, hulumtim shkencor dhe ndërveprim aktiv me komunitetin dhe partnerët institucionalë.

Puna me Arkiva dhe Koleksione muzeale

Gjatë gjithë vitit është punuar në arkivat e Muzeut të Mitrovicës:

Puna në arkivat muzeale është një proces i vazhdueshëm, i cili nuk përfundon asnjëherë, por zhvillohet paralelisht me rritjen e koleksioneve, hulumtimet e reja dhe nevojat institucionale. Gjatë vitit 2025, Muzeu i Mitrovicës ka arritur rezultate konkrete dhe të matshme në këtë drejtim, duke intensifikuar punën në arkiva dhe duke përmirësuar ndjeshëm sistemimin, dokumentimin dhe qasjen në materialet arkivore.

Gjatë vitit 2025, Muzeu i Mitrovicës ka përmirësuar dhe sistemuar arkivat dhe koleksionet muzeale, duke garantuar ruajtjen dhe qasjen e tyre për aktivitete edukative dhe ekspozita. Konkretisht:

- Është rregulluar Biblioteka e Muzeut, duke vendosur vitrina të dhuruara nga Biblioteka Latif Berisha për sistemimin e titujve muzealë, si dhe janë digjitalizuar mbi 500 tituj nga ky fond.
- Janë trajtuar rreth 150 objekte arkeologjike, të gatshme për ekspozim në ekspozitën "Mitrovica Neolitike".
- Fosilet janë pastruar, trajtuar dhe ekspozuar në mënyrë të duhur.
- Janë pastruar, fotografuar dhe sistemuar rreth 150 objekte etnologjike në kuadër të projektit "Trashëgimia në Fije", për të cilat është blerë material adekuat për sistemim dhe ruajtjeje, përfshirë kuti plastike të formave të ndryshme, materiale tekstili, dorashka, mburoja, syze, maska dhe mantile.
- Janë sistemuar mbi 300 foto nga fototeka e muzeut.
- Janë trajtuar me riparime të lehta (qepje) koleksioni i veshjeve tradicionale, si dhe janë pastruar aksesoret metalikë të koleksionit etnologjik.
- Ka filluar dokumentimi digjital i procesit të krijimit të çejzit qytetar dhe gajtanit, punë që do të vazhdojë edhe më tutje.

1.3 Pasurimi i muzeut me artefakte dhe objekte të veçanta

Muzeu i Mitrovicës u pasurua me disa artefakte dhe objekte të veçanta, të cilat kontribuojnë në dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe historike:

- Dy objekte të veçanta etnologjike: një jelek me gajtan ari dhe një këmishë e mëndafshhtë, të punuara me mjeshtëri në Gjakovë në vitin 1977 për zonjën Sadije Kaçamaku, e cila u martua në familjen Llapashtica në Vushtrri. Këto u dhuruan nga znj. Nezahate Zhilivod.
- Znj. Nezahate Peja Çaushi nga Mitrovica dhuroi jelekun e saj me gajtan ari Muzeut të Mitrovicës. Jeleku është punuar në qytetin e Gjakovës, në vitin 1974, nga znj. Fakete Kazazi Shyti.
- Pjesë të punës së dorës dhe çejzit qytetar, mbulesa tavolone dhe mindile të punuara me teknikën e vrimave, të dhuruara nga znj. Nexhlal Deda.
- Një djep i vjetër nga druri dhe një shoshe metalike, të dhuruara nga familja Isufi.

- Këpucë dhe xhaketa të veshura gjatë eksodit të Luftës së Fundit 1998–1999 , të dhuruara nga Bajram Mustafa.
- Ditari i luftës i z. Mustafë Shala, i dhuruar nga znj. Afete Shala, që përfshin dorëshkrime dhe dëshmi të eksodit gjatë Luftës së Fundit 1998–1999.

Informimi i publikut

Në kuadër të vitit të punës në muze, u dhanë intervista për TV lokale dhe qendrore si: RTK, TV Dukagjini, KlanKosova, T7 e shumë të tjera:

- Emisioni edukativ Porta – RTK- Drejtoresha Nora Prékazi diskutoi rolin e muzeve në njohjen e historisë dhe rëndësinë e veprimtarisë muzeale për edukimin e vizitorëve.
- Lajme për hapjen e ekspozitës “TESTAMENT” – TV / media lokale- Raportime mbi hapjen e ekspozitës, e cila promovoi diversitetin dhe barazinë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- Raportime për ekspozitën “Mitrovica Neolitike”- Media kulturore dhe lokale raportuan hapjen e ekspozitës arkeologjike më 31 korrik 2025, duke e paraqitur si një ngjarje kyçe muzeale të vitit.
- Artikuj dhe intervista për sfidat dhe planet e muzeut
- Në Telegrafi dhe Kosovapress u publikuan prononcime të drejtoreshës për sfidat e muzeut pa objekt të përhershëm, përpjekjet për renovim dhe synimin për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj grupeve të marginalizuara.
- Emisioni Expres- Ka mbuluar hapjen dhe aktivitetet e ekspozitës “MOZAIK – Praktika të Artit Komunitar”, duke përfshirë programet edukative dhe bashkëpunimet me komunitetin.
- Promovimi i punës muzeale gjatë vitit u realizua gjithashtu përmes portaleve lokale si: Jëpi Zë, Mitropol, Qyteti i Mitrovicës, etj;

Vizitorët

Gjatë vitit 2025, Muzeu i Qytetit të Mitrovicës mirëpriti një numër të konsiderueshëm vizitorësh, duke përfshirë:

- Grupa nga shkollat fillore dhe të mesme.
- Studiues dhe studentë nga universitete të ndryshme.
- Vizitorë individualë dhe familjarë, vendorë, të huaj dhe bashkatdhetarë.
-

Për të pasur një vlerësim të saktë të vizitave, Muzeu mbajti evidencë të detajuar të numrit të vizitorëve për çdo aktivitet dhe ekspozitë, duke monitoruar kështu fluksin dhe interesin e publikut.

Rritja e numrit të vizitorëve ishte rezultat i një kalendari të pasur me aktivitete kulturore dhe edukative, duke përfshirë:

- Organizimin e gjashtë ekspozitave tematike të veçanta.
- Realizimin e programeve edukative me panele diskutuese dhe punëtori për grupmosha të ndryshme.
- Shfrytëzimin e hapësirave muzeale si vend për koncerte të muzikës klasike.

Falë këtyre përpjekjeve dhe monitorimit të kujdesshëm të vizitave, Muzeu arriti një numër vizitorësh prej rreth 10,000 gjatë vitit

Nevoja prioritare për përmirësimin e funksionimit të Muzeut të Mitrovicës:

- **Sistemimi i objektit të përhershëm të Muzeut.**
- **Hartimi i Planit të Menaxhimit** për punën dhe zhvillimin institucional.
- **Hartimi dhe Miratimi i Programit Edukativ nga komuniteti** për vazhdim të punës konstruktive me komunitet dhe për komunitet;
- **Plotësimi i stafit profesional**, me fokus në ekspertizën muzeore.
- **Siguria e objektit muzeal**, përmes instalimit të sistemit të alarmit.
- **Rritja e buxhetit vjetor** për agenda kulturore dhe programe edukative dhe investime kapitale.
- **Rikonstruksioni i hapësirave muzeale**, për të përmbushur nevojat dhe standardet bashkëkohore.
- **Pasurimi me pajisje digjitale dhe teknike**, për avancimin e proceseve

profesionale për stafin dhe ekspozitat.

- **Inventar i ri muzeal**, me vitrina adekuate sipas udhëzuesve administrativë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe inventar zyresh për mirëqenien e stafit muzeal;
- **Trajnime profesionale të stafit** përmes aktiviteteve të vazhdueshme, trajnimeve dhe vizitave studimore;

7. Synimi dhe veprimet në të ardhmen

- **Miratimi i selisë së përhershme të Muzeut:** ku ish-objekti i Armatës Jugosllave caktohet si seli e e përhershme e Muzeut të Mitrovicës, miratuar me vota nga Kuvendi Komunal;
- **Rikonstruimi i hapësirës për nevoja të Muzeun e Mitrovicës:** Puna përfshinë rinovimin dhe ristrukturimin e hapësirave muzeale për të siguruar kushte të përshtatshme për ruajtje, ekspozim dhe zhvillim të aktiviteteve kulturore.
- **Ri-inventarizimi i gjithë koleksionit muzeal:** Kryerja e një procesi të plotë inventarizimi të koleksionit muzeal, duke përfshirë dokumentimin, digjitalizimin dhe paketimin e duhur të artefakteve dhe materialeve muzeale.
- **Mbledhja e artefakteve dhe materialeve muzeale:** Vazhdimi i mbledhjes dhe ruajtjes së artefakteve që pasurojnë fondin muzeal, duke u fokusuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të qytetit.
- **Mbledhja e memories kolektive të qytetit:** Grumbullimi dhe ruajtja e kujtimeve dhe historive të qytetit të Mitrovicës, për të pasuruar koleksionet me aspekte të rëndësishme të historisë dhe kulturës lokale.
- **Ngritja e vizibilitetit dhe rritja e numrit të vizitorëve:** Zhvillimi i aktiviteteve dhe strategjive për të tërhequr më shumë vizitorë dhe për të rritur prezencën e muzeut në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
- **Forcimi i partneriteteve me institucione dhe subjekte relevante:** Krijimi dhe zhvillimi i partneriteteve me institucione kulturore, akademike dhe shoqërore për të rritur kapacitetet e muzeut dhe për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim afatgjatë.

3.2. Aktivitete të Programit Edukativ të Muzeut të Mitrovicës

Grupi i Thurjes – Ekspozita Etnologjike “Një Jetë në Gajtan”

Aktivitet krijues për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë gra artizane dhe pjesëtare të komunitetit. Qëllimi: Rikthimi dhe promovimi i thurjes si pjesë e trashëgimisë kulturore.

Datat dhe vendet:

- 19 Shkurt 2025, ora 17:30 – Muzeu i Mitrovicës
- 10 Prill 2025, ora 17:30 – Muzeu i Mitrovicës
- 14 Maj 2025, ora 17:30 – Muzeu i Mitrovicës
- 31 Tetor 2025, ora 17:00 – Muzeu i Mitrovicës
- 24 Nëntor 2025, ora 17:30 – Muzeu i Mitrovicës
- 8 Dhjetor 2025, ora 17:30 – Muzeu i Mitrovicës

Punëtori vizatimi për fëmijë dhe të rinj

Përfshin fëmijë nga shkolla të ndryshme dhe grupe të marginalizuara. Datat dhe vendet:

- 11 Prill 2025, ora 13:30 – Muzeu i Mitrovicës
- 25 Prill 2025, ora 10:00 – Program me të rinjtë nga komuniteti me Sindromen Down
- 28 Tetor 2025, ora 11:00 – Muzeu i Mitrovicës, në bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra

Aktivitetet e Muzeut Lëvizës

Programi përfshiu fëmijë nga fshati Bare dhe nxënës të shkollave të ndryshme. Datat dhe vendet:

- 27 Tetor 2025, ora 11:00 – Qendra Kulturore “Bare”, në bashkëpunim me SHFMU “Xhevat Jusufi”
- Punëtori me fëmijë në Muzeun e Mitrovicës: 28 Tetor 2025

Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2025

Aktivitet kreativ për fëmijë: “Trashëgimia me ngjyra të fëmijëve”

Data: 26 Shtator 2025, ora 11:00

Vendi: Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Terezë” – Mitrovicë

Aktivitetet Kulturore të Organizuara në Muzeun e Mitrovicës

- **Koncert Festiv për Nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës nga SHFMU Tefta Tashko**

Nxënësit interpretuan vepra të kompozitorëve shqiptarë me pasion dhe emocion.

- **Gara e Pianos nga SHFMU Tefta Tashko**

Nxënësit e klasave të pianos shfaqën talentin dhe përparimin e tyre artistik. Mësimdhënësit: Endi Abrashi, Fisnik Komtrashi, Valeza Hasani, Saranda Kutillovci Syla, Rina Ferri Ademi, Florina Bunjaku, Melisa Ibrahimimi.

- **Koncert Festiv për Ditën e Shkollës së Muzikës “Tefta Tashko”**

Nxënësit interpretuan repertor klasik dhe bashkëkohor, duke përfshirë instrumente të ndryshme dhe paraqitje vokale.

- **Program Artistik “I këndojmë atdheut ditën e lirisë” nga SHFMU Tefta Tashko**

Realizuar me rastin e Ditës së Paqes, në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës.

- **Koncerti i Fundvitit 2025 nga SHFMU Tefta Tashko**

Një aktivitet i veçantë i mbushur me muzikë, përkushtim dhe talent. Nxënësit shpalosën punën dhe dashurinë për artin muzikor.

Koncerte të Muzikës Klasike të Mbajtura në Muzeun e Mitrovicës

- **Koncerti me dirigjentin Leonardo Quadrini dhe orkestrën italiane**

Një mbrëmje speciale në kuadër të International Piano Balkan Academy, mbajtur në Sallën Etnologjike me pianisten Melisa Ibrahimimi, dhe i përkrahur nga DKRS – Mitrovicë.

- **Koncert për veprat e Reynaldo Hahn me vokalisten Fiona Shabani dhe pianisten Lirika Pula**

Një interpretim i veçantë i veprave të kompozitorit francez në prani të ekspozitës “Një Jetë në Gajtan”. Bashkëpunim me Muzeun e Mitrovicës dhe mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

2. Vizitat e shkollave dhe puna me komunitetin

Gjatë vitit 2025, Muzeu i Mitrovicës zhvilloi një sërë vizitash edukative dhe aktivitete komunitare, duke e bërë muzeun një hapësirë gjithëpërfshirëse për mësim, kulturë dhe trashëgimi. Këto aktivitete përfshinë nxënës nga shkolla fillore dhe të mesme, studentë universitarë, grupe të marginalizuara dhe me nevoja të veçanta, si dhe delegacione ndërkombëtare.

Shkolla dhe institucione të tjera që vizituan muzeun përfshijnë:

- SHFMU “Bedri Gjinaj”
- SHFMU “Nënda Bulka” (ekspozita arkeologjike “Mitrovica Neolitike”)
- SHFMU “Vezir Jashari” – Ferizaj

- SHFMU “Fazli Grejçevci” – Shipol, SHFMU “Sylejman Vokshi” – Broboniq, Gjinnazi “Frang Bardhi”
- SHFMU “Aziz Sylejmani”
- SHFMU “Eqrem Çabej” – Mitrovicë
- SHFMU “Ismail Qemajli”
- Shkolla e Mesme Teknike “Arkitekt Sinani”
- The British School of Kosova
- SHFMU “Xhevat Jusufi” – Bare

Vizita universitare dhe studimore përfshinë:

- Universiteti “Isa Boletini” – Mitrovicë, së bashku me kolegë nga universitete të Shqipërisë, University of Gloucestershire (UK) dhe International School for Social and Business Studies (Slloveni)
- Fakulteti i Filozofisë – Dega Arkeologji dhe Antropologji Kulturore, Universiteti i Prishtinës
- Universiteti Eberhard Karls i Tübingenit, Gjermani
- Studentë kanadezë që studiojnë nacionalizmin dhe identitetin Grupet dhe delegacionet me nevoja të veçanta përfshinë:
- Persona me nevoja të veçanta, në kuadër të aktiviteteve të OSCE-së
- Delegacioni ndërkombëtar i projektit Y-WISE Erasmus+ Youth (pjesëmarrës nga 12 vende)
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Down Syndrome Kosova – dega Mitrovicë

Gjatë vizitave, nxënësit dhe pjesëmarrësit u angazhuan në aktivitete kreative si punëtoritë e vizatimit, ku krijuan punime inspiruara nga ekspozitat muzeale dhe trashëgimia kulturore. Këto aktivitete forcuan përkushtimin e Muzeut të Mitrovicës për një qasje gjithëpërfshirëse dhe për të garantuar mundësi të barabarta për të gjitha grupmoshat dhe komunitetet.

Biblioteka e qytetit “Latif Berisha”

Spektori i përpunimit janë përpunuar gjithsej 695 tituj.

Në spektorin e fëmijëve janë përpunuar dhe dorëzuar gjithsej 111 tituj dhe 195 ekzemplarë, ku gjatë vitit janë anëtarësuar gjithësejt 463 fëmijë dhe pra anëtarë të rinjë dhe ka pasur 16351 shërbime .

Në sektorin për të rritur janë dorëzuar 144 tituj dhe 289 ekzemplarë, gjatë vitit 2025 janë anëtarësuar 187 anëtar të rinjë dhe ka 5850 shërbime.

Në sektorin e profesional janë dorëzuar 70 tituj 123 ekzemplarë, gjatë vitit 2025 janë anëtarësuar 163 anëtar dhe ka 2540 shërbime .

Spektori i periodikut janë evidentuar dhe përpunuar 4 tituj dhe 27 ekzemplarë, revista dhe seri.

Nendega e Bibliotekese në fshatin Kqiq në vitin 2025 janë kryer 400 shërbime

Tunel te parë në vitin 2025 janë kryer 380 shërbime.

Fshatin Bare në vitin 2025 janë kryer mbi 200 shërbime

Në vitin 2025 nga regjistrimet e anëtarëve të rinjë kemi të hyra 2,650.00

Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica

Janar :

30.01.2025 - Mbrëmje e muzikës klasike, nga shkolla e muzikës “Tefta Tashko”.

Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

Pjesëmarrja, rreth 150 persona.

Shkurt :

18.02.2025 - Prezantimi i shfaqjes “Hope” nga Baleti Kombëtar i Kosovës.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 70 persona.

Mars :

24.03.2025 - Akademi përkujtimore me rastin e 26 vjetorit të vrasjes së Agim Hajtazit.

Salla e Kinemasë, në ora 13:00.

Pjesëmarrja, rreth 180 persona.

Prill :

03.04.2025 - Dita e shkollës “Abadullah Shabani” .

Salla e Kinemasë dhe Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 15:00.

Pjesëmarrja, rreth 250 persona.

08.04.2025 - Promovimi i librit “Një jetë me Skënderbeun” nga autori Namik Selmani.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 25 persona.

29.04.2025 - Koncert nga këngëtarja Elina Duni.

Salla e Kinemasë, në ora 20:00.

Pjesëmarrja, rreth 200 persona.

Maj :

01.05.2025 - Koncert nga Nils Kugelman.

Salla e Kinemasë, në ora 20:00.

Pjesëmarrja, rreth 100 persona.

07.05.2025 - Panair gjithpërfshirës nga shkollat e mesme të Mitrovicës.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 300 persona.

19.05.2025 - Performancë nga pianisti Yll Haliti.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 30 persona.

23.05.2025 - Shfaqja “Këmisha e Lirisë” nga rrjeti i grave të Kosovës.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 20 persona.

Qershor :

02.06.2025 deri më **04.06.2025** - Gara e parë klasike në Mitrovicë nga “Mitrovica Classical Competition”.

Salla e Kinemasë.

Pjesëmarrja, rreth 100 persona.

03.06.2025 - Festa e Abetares nga shkolla fillore “Eqrem Çabej”.

Salla e Kinemasë, në ora 10:00.

Pjesëmarrja, rreth 300 persona.

09.06.2025 - Festa e Abetares nga shkolla Fillore “Nonda Bulka”

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 60 persona.

10.06.2025 - Festa e Abetares nga shkolla fillore “Andon Zako Çajupi”.

Salla e Kinemasë, në ora 10:00.

Pjesëmarrja, rreth 230 persona.

11.06.2025 - Festa e Abetares nga shkolla fillore “Andon Zako Çajupi”.

Salla e Kinemasë, në ora 11:00.

Pjesëmarrja, rreth 140 persona.

13.06.2025 - Promovimi i dy librave kushtuar albanologut Ullmar Qvick, nga autori Fetah Bahtiri.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 25 persona.

13.06.2025 - Program artistik nga “Shqipet e Vogla”.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja rreth 150 persona.

20.06.2025 - Program artistik nga shkolla fillore “Musa Hoti”.

Salla e Kinemasë, nga ora 10:00 deri në ora 15:00.

Pjesëmarrja, rreth 150 persona.

26.06.2025 - Tubim nga partia “GUXO”. Shpallja e kandidaturës për kryetar të komunës së Mitrovicës.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 200 persona.

27.06.2025 - Kopshti i Fëmijëve “Qershia” - program argëtues - artistik për fëmijët.

Salla e Kinemasë, në ora 10:30.

Pjesëmarrja, rreth 60 persona.

Shtator :

Nga data **15.09.2025** deri më **19.09.2025** - Festivali Tradicional i Komedisë “Mittrix Fest”

Salla e Kinemasë, në ora 20:00.

Pjesëmarrja, rreth 1000 persona.

20.09.2025 - Tubim elektorat nga LDK.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

26.09.2025 - Dokumentar “Luani me rrotë nëpër botë” - kushtuar mitrovicasit Luan Qabra.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 60 persona.

Tetor :

03.10.2025 - Akademi përkujtimore për Faruk Spahiu.

Salla e Kinemasë, në ora 11:00.

Pjesëmarrja, rreth 220 persona.

03.10.2025 - Tubim elektorat nga Vetëvendosje - Guxo.

Salla e Kinemasë, në ora 17:00.

06.10.2025 - Tubim elektorat nga Vetëvendosje.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

07.10.2025 - Tubim elektorat nga AKR.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

08.10.2025 - Tubim elektorat nga PDK.

Salla e Kinemasë, në ora 17:30.

Nëntor :

12.11.2025 - Drama “Jehonat e heshtjes” nga grupi “Nexhip Menekshe”. Organizuar nga asociacioni i grave të Mitrovicës, për të drejtat e njeriut.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 30 persona.

16.11.2025 - Mbrëmja përmbyllëse e festivalit ndërkombëtar “Mitrovica guitar days”.

Salla e Kinemasë, në ora 19:30.

Pjesëmarrja, rreth 200 persona.

26.11.2025 - Koncert pianistik, pjesë e programit të festivalit të edicionit, të vitit 2025, në kuadër të Mitrovica Classical Competition.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 50 persona.

Dhjetor :

03.12.2025 - Shfaqja “Kultura pa barriera” - organizuar nga personat me aftësi të kufizuara.

Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

Pjesëmarrja, rreth 160 persona.

08.12.2025 dhe **09.12.2025** - Shfaqja për fëmijë “Lalushi në shpellë” me autor dhe regjisor Ali Qerimi nga Shkupi.

Salla e Kinemasë.

Pjesëmarrja, rreth 1100 persona, në 8 termine.

12.12.2025 - Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe betimi i kryetarit të zgjedhur, z.Faton Peci.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 300 persona.

12.12.2025 - Program artistik nga “Shqipet e vogla”.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Pjesëmarrja, rreth 200 persona.

17.12.2025 - Shtëpia botuese “Dukagjini” promovon lektyra shkollore.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

Pjesëmarrja, rreth 220 persona.

19.12.2025 dhe **20.12.2025** - Mitrovica Electric Guitar Academy nga “Kosova Ars”.

Salla e Kinemasë, në 19:30.

Pjesëmarrja në dy terminet, rreth 60 persona.

23.12.2025 - Tubim elektorale nga LDK.

Salla e Kinemasë, në ora 17:00.

26.12.2025 - Tubim elektorale nga VV.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 20:00.

27.12.2025 - Program festiv me nxënës nga Sidi Education.
Salla e Kinemasë, në ora 13:30.
Pjesëmarrja, rreth 40 persona

Teatri i qytetit "Muharrem Qena"

Ky raport vjetor paraqet aktivitetet artistike dhe përfaqësuese të realizuara nga Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë gjatë vitit 2025 dhe i adresohet Komunës së Mitrovicës së Jugut si institucion themelues dhe mbështetës.

1. Përmbledhje e Përgjithshme

Gjatë vitit 2025, Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë ka realizuar një program të pasur artistik me premiera, repriza, shfaqje mysafire dhe pjesëmarrje në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Aktivitetet Artistike të Realizuara

Data	Shfaqja	Vendi / Statusi
06.02.2025	"Audienca"	Premiere – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
13.02.2025	"Audienca"	Reprizë – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
27.02.2025	"Menaxheria e Qelqtë"	Premiere – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
03.03.2025	"Menaxheria e Qelqtë"	Reprizë – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
10.03.2025	"Menaxheria e Qelqtë"	Reprizë – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
14.03.2025	"Menaxheria e Qelqtë"	Mysafire – Teatri Kombëtar i Kosovës
27.03.2025	"Kontesha Arduini"	Premiere – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
03.04.2025	"Kontesha Arduini"	Reprizë – Teatri "Muharrem Qena" – Mitrovicë
15.03.2025	"Kontesha Arduini"	Mysafire – Teatri Adriana, Ferizaj

17.04.2025	“Provinca”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
23.04.2025	“Provinca”	Mysafirë – Kamenicë
25.04.2025	“Revolta e Presjes”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
28.04.2025	“Provinca”	Mysafirë – Teatri Kombëtar
08.05.2025	“Menaxheria e Qelqtë”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
12.05.2025	“Kontesha Arduini”	Mysafirë – Teatri Kombëtar
15.05.2025	“Kontesha Arduini”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
22.05.2025	“Provinca”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
23.05.2025	“Provinca”	Mysafirë – Teatri i Qytetit, Gjilan
26.05.2025	“Menaxheria e Qelqtë”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
29.05.2025	“Revolta e Presjes”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
02.06.2025	“Art”	Mysafirë – Teatri Kombëtar
10.06.2025	“Kontesha Arduini”	Festival – Babel Fest, Rumani
16.06.2025	“Revolta e Presjes”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
19.06.2025	“Provinca”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
30.06.2025	“Menaxheria e Qelqtë”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë
10.07.2025	“Bouncers”	Mysafirë – Kastriot Saqipi
19.07.2025	“Provinca”	Festival – Etno Fest, Kukaj
06.12.2025	“Provinca”	Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë

3. Përfundim

Teatri “Muharrem Qena” – Mitrovicë do të vazhdojë me përkushtim realizimin e programeve artistike cilësore dhe përfaqësimin dinjitoz të qytetit dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut

Spektori i Rinisë

Gjatë vitit raportues, Spektori i Rinisë ka zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim fuqizimin e rolit të të rinjve në komunitet, promovimin e jetesës së shëndetshme, zhvillimin e kreativitetit dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me shkolla, organizata rinore, institucione shëndetësore dhe partnerë lokalë.

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Rinisë në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe përfshin periudhën kohore 2025.

Ky Sektor vëmendje dhe përkushtim të vecantë i ka kushtuar fuqizimit të të rinjve, përmes formave të ndryshme të organizimit institucional duke shënuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Në veçanti DKRS njeh rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje në të gjitha proceset që e prekin stautin e të riut dhe zhvillim individual si qytetarë aktiv sot dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës tani dhe në të ardhmën..

Në vitin 2025 Sektori i Rinisë ka filluar me promovimin e rregullorës për vullnetarizëm, dokument ky shume me interes për të rinjtë e qytetit të Mitrovicës.

02 Shkurt së bashku me drejtorin e drejtorisë kemi takuar përfaqësuesit e, OJQ RINAS, OJQ IBY, OJQ MDNZ.

Qëllimi I këtij takimi ishte thellimi I bashkëpunimit në implementimin e projekteve të përbashkëta, DKRS ofroi bashkëpunim, trajtim të mirë dhe të barabartë dhe qasje gjithëpërfshirëse në implementimin e politikave rinore në Komunën e Mitrovicës.

OJQ-të vlerësuan lartë kontributin e Drejtoris për punën e palodhshme ndër vite si në sektorin e shoqërisë civile, rinisë dhe në fushat e tjera.

3 Mars, Organizuar nga Prishtina REA në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Qendrën Rinore të Mitrovicës sot në ambientet e Qendrës Rinore Diakonia është bërë ndarja e Certifikatave për të gjithë pjesëmarrësit të cilët suksesshëm kanë kaluar të gjitha programet e trajnimit në fushën e Dizajnit Grafik, printim digjital, kamerë dhe montazh.

Gjithashtu me 21 Mars u shënuar Dita e Pranverës ku se bashku me disa të rinje drejtorja organizoi një aktivitet për pastrimin e qytetit.

Me 31 Maj u shënuar Dita Nderkombetare Kunder Duhanit. Shpërndarje e broshurave informuese për pasojat e duhanit

Vendosje e posterëve sensibilizues në shkolla dhe hapësira publike Ligjërata nga profesionistë shëndetësorë për efektet e dëmshme të duhanit.

26 Qershor Dita Nderkombetare Kunder Narkotikve Shpërndarje e materialeve informuese për rreziqet e përdorimit të narkotikëve Postime sensibilizuese në rrjetet sociale të komunës

Vendosje e pankartave me mesazhe "Thuaj JO Drogës.

Aktiviteti për ditën nderkombetare të rinisë 12 gusht. Diskutim mbi rolin e të rinjve në vendimarrje prezantim i mundësive për përfshirje në projekte rinore bashkëbisedim me

përfaqësues të komunës Ekspozitë me punime të të rinjve promovim i organizatave rinore regjistrim për aktivitete vullnetare.

Java e Rinisë muaji shtator periudhë e veçantë e organizuar për të rinjtë ,zakonisht me aktivitete edukative , kulturore, sportive dhe sociale

Debate , trajnime dhe puntori edukative ,aktivitete vullnetare dhe sociale,fuqizimi i të rinjëve ,provovojnë talent të rinjë.

Kemi organizuar neper shkollat e Mitrovicës puntori me temat vullnetarizmi, bullizmi.

Me rastin e 1 Dhjetorit – Ditës Botërore Kundër HIV/AIDS, Sektori i Rinisë organizoi aktivitete ndërgjegjëse me qëllim informimin dhe edukimin e të rinjve lidhur me parandalimin, mënyrat e transmetimit dhe rëndësinë e testimit për HIV/AIDS.

Aktivitetet përfshinë shpërndarje të materialeve informuese, ligjërata edukative dhe diskutime të hapura me të rinjtë. Përmes këtyre veprimtarive u synua rritja e vetëdijes, luftimi i stigmës dhe promovimi i sjelljeve të shëndetshme në komunitet.

Aktivitetet kanë përfshirë një numër të konsiderueshëm të rinjsh nga komuniteti, duke nxitur bashkëpunimin, kreativitetin dhe ndërgjegjësimin për çështje sociale dhe shëndetësore. Sektori i Rinisë mbetet i përkushtuar në krijimin e mundësive të reja për të rinjtë, duke synuar zhvillimin e tyre personal dhe profesional, si dhe ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe të shëndetshëm.

Sektori i Sportit

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Sportit në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe përfshinë mbështetjen financiare të klubeve sportive për vitin 2025 dhe raportimin e tyre.

Aktivitetet e implementuara gjate kësaj periudhe kohore janë te bazuara ne Planin e Punës .

Sektori i Sportit , njëri nga tre sektorët e DKRS-së është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve sportive dhe mbarëvajtjen e punës në sektor.

Ky Sektor vëmendje dhe përkushtim të veçantë i ka kushtuar klubeve sportive te qytetit tone , përmes formave të ndryshme të organizimit institucional duke shënuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Me datën 21.01.2025 është hapur shpallja publike për subvencionimin e klubeve /shoqatave sportive ku afati për aplikim ka qene deri me 11.02.2025 , gjate këtij afati kane aplikuar 46 klube /shoqata sportive

Nr.	Emri i Organizates/klubit	Aplikuesit
1.	Kl.Basketbollit "Trepça" (M)	Aplikues
2.	Kl.Futbollit . "Trepça"89	Aplikues
3.	Kl.Futbollit "Mitrovica" (femrat)	Aplikues
4.	Kl.Futbollit . "Trepça"	Aplikues
5.	Kl. Hendbollit"Trepça"(M)	Aplikues
6.	Kl. Xhudos "Trepça"	Aplikues
7.	Kl.Basketbollit "Trepça" (F)	Aplikues
8.	Kl Futbollit "Mitrovica" meshk	Aplikues
9.	Kl. Fusall " Trepça"	Aplikues
10.	Kl. Hendbollit"Trepça"(F)	Aplikues
11.	KL futbollit "Bardhi "	Aplikues
12.	Ojq Qendra Nacio,e Vezhguseve	Aplikues
13.	Kl. Boksit " diakonia "	Aplikues
14.	Kl. Karates "Mitrovica "	Aplikues
15.	OJQ Katuni i Moqum	Aplikues
16.	Kl. Boksit " Trepça" 89	Aplikues
17.	Kl. Notit " Mitrovica"	Aplikues
18.	Kl. Volejbollit " Trepça" (F)	Aplikues
19.	Kl. Çiklizmit	Aplikues
20.	Kl. Atletikes "Trepça"	Aplikues
21.	Kl. Body Bidingut "Trepça"	Aplikues
22.	Kl. Atletikes "Mitrovica "	Aplikues
23.	Ojq Opfakos	Aplikues
24.	Ojq Mitrosport	Aplikues
25.	Shoqata bjeshkatore " Trepça"	Aplikues
26.	Kl. Boksit " Trepça"	Aplikues
27.	Kl.Veteraneve " Mitrovica"	Aplikues
28.	Kl. Futbollit ' Shpresa'	Aplikues
29.	Kl. Armcrushers " Trepça"	Aplikues
30.	Kl. Top Team "Mitrovica "	Aplikues
31.	Sh.R.K.F.S. fucall Mitrovica	Aplikues
32.	Kl.i Baketbollit "Veteranet"	Aplikues
33.	Ojq Masterboll	Aplikues
34.	Sporti pa kufi	Aplikues
35.	Kl. Fusall " Minatori"	Aplikues
36.	Asociacioni i parasht. Kosovës	Aplikues

37.	Sh.F.S.R "Ibri"		Aplikues
38.	Travil Explorers Kosova		Aplikues
39.	Kl. I Kickboxit		Aplikues
40.	Ojq Premisa		Aplikues
41.	Shoqata nderkm.te verbeve		Aplikues
42.	Kl I Pakados "Trepca"		Aplikues
43.	Kl Gara Automob. Mitrovica		Aplikues
44.	KPBO Pak Minatori		Aplikues
45.	Kl Para shejtarise "Lum Bardhi"		Aplikues
46.	Education Innovators Kosova		Aplikues

Për tejkalimin e afateve ligjore me datën 11.03.2025 anulohet thirrja e pare publike.

1.Me datën 13.01.2025 është mbajtur turniri ne grup mosha U-11 dhe U-13 ne fushën sintetike , ku te pranishëm kane qene 48 ekipe ku ne mesin e këtyre ekipeve kanë marr pjese edhe nga Shqipëria ,Maqedonia dhe Mali i Zi.


Me gjeneratën U-11 ishin pjesëmarrës 24 ekipe .

Me gjeneratën U-13 ishin pjesëmarrës 24 ekipe .

Fotot nga turneu Mitrovica Cup



2.Realizimi i Turnirit tradicionale 17 shkurt dita e pavarësisë ne futboll te vogël





3. Me datën 26.04.2025 është mbajtur turniri për Heroin e Kosovës Shemsi Ahmeti , financimin e turnirit e ka bërë Drejtoria për Kulturë ,Rini dhe Sport .

Ne këtë turnir vendin e parë e zuri Policia e Kosoves






5. Në kuadër të masivizimit të sportit janë ndihmuar materialisht dhe janë realizuar, përmes Shoqatës së pedagogëve dhe arsimtarëve të edukatës fizike dhe sportit shkollor, Garat sportive shkollore me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës, të cilat tashmë janë tradicionale dhe ku përfshihen një numër i konsideruar i të rinjve.

Subvencionimi i klubeve sportive realisht ndikon dhe ndihmon gjithashtu në masivizimin e sportit me vetë faktin se në kuadër të gjitha klubeve sportive funksionojnë edhe shkollat sportive për sportet gjegjëse dhe ku janë të përfshirë kryesisht grup moshat e reja.

Bie fjala në futboll organizohet edhe kampionati i futbollit përmes Ligës Regjionale dhe ku pjesëmarrës janë të gjitha klubet e futbollit të qytetit por edhe të regjionit, për 3 (tri) kategori si pionier të rinjë, pionier dhe kadet dhe ku përfshihet një numër tejet i madh i të rinjve të këtyre moshave.





6. Ne si sektor kemi bere takime me klubet sportive ku kemi biseduar rreth terminëve dhe organizimit te klubeve , shqetësimi i tyre ishte infrastruktura sportive .

Disa nga përfaqësuesit e klubeve theksoj se ne sezonin e kaluar disa lojë i kemi zhvilluar ne qytetet te ndryshme te Kosovës pa pagës, se ne fushën ku jemi tash pra ne fushën "XHevat Jusufi Xheki" te gjitha i kemi me pagës, si stërvitje po ashtu edhe lojërat kampionale.

8. Me datën 28.07.2025 është hapur shpallja e dyte publike për subvencionimin e klubeve /shoqatave sportive , gjate këtij afati kane aplikuar 53 klube /shoqata sportive

Nr.	Emri i Organizates/klubit		Aplikuesit
1.	Kl.Basketbollit "Trepça" (M)		Aplikues
2.	Kl.Futbollit . "Trepça" 89		Aplikues
3.	Kl.Futbollit "Mitrovica" (femrat)		Aplikues
4.	Kl.Futbollit . "Trepça"		Aplikues
5.	Kl. Hendbollit "Trepça" (M)		Aplikues
6.	Kl. Xhudos "Trepça"		Aplikues
7.	Kl.Basketbollit "Trepça" (F)		Aplikues
8.	Kl Futbollit "Mitrovica " meshk		Aplikues
9.	Kl. Fusall " Trepça"		Aplikues
10.	Kl. Hendbollit "Trepça" (F)		Aplikues

11.	KL futbollit "Bardhi "		Aplikues
12.	Ojq Qendra Nacio,e Vezhguseve		Aplikues
13.	Kl. Boksit " diakonia "		Aplikues
14.	Kl. Karates "Mitrovica "		Aplikues
15.	OJQ Katuni i Moqum		Aplikues
16.	Kl. Boksit " Trepça" 89		Aplikues
17.	Kl. Notit " Mitrovica"		Aplikues
18.	Kl. Volejbollit " Trepça" (F)		Aplikues
19.	Kl. Çiklizmit		Aplikues
20.	Kl. Atletikes "Trepça"		Aplikues
21.	Kl. Body Buildingut "Trepça"		Aplikues
22.	Kl. Atletikes "Mitrovica "		Aplikues
23.	Ojq Opfakos		Aplikues
24.	Ojq Berliku		Aplikues
25.	Shoqata bjeshkatore " Trepça"		Aplikues
26.	Kl. Boksit " Trepça"		Aplikues
27.	Kl.Veteraneve " Mitrovica"		Aplikues
28.	Kl. Futbollit ' Shpresa'		Aplikues
29.	Kl. Armcrushers " Trepça"		Aplikues
30.	Kl. Top Team "Mitrovica "		Aplikues
31.	Sh.R.K.F.S. fucall Mitrovica		Aplikues
32.	Kl.i Baketbollit "Veteranet"		Aplikues
33.	Ojq Masterboll		Aplikues
34.	Sporti pa kufi		Aplikues
35.	Kl. Fusall " Minatori"		Aplikues
36.	Asociacioni i parasht. Kosovës		Aplikues
37.	Sh.F.S.R "Ibri"		Aplikues
38.	Travil Explorers Kosova		Aplikues
39.	Kl. Kickboxit		Aplikues
40.	Ojq Premisa		Aplikues
41.	Shoqata nderkm.te verbeve		Aplikues
42.	Kl I Pakados "Trepca"		Aplikues
43.	Kl Gara Automob. Mitrovica		Aplikues
44.	KPBO Pak Minatori		Aplikues
45.	Kl Para shejtarise "Lum Bardhi"		Aplikues
46.	Kl. Shahut " Policia e Kosovës'		Aplikues
47.	Education Innovators Kosova		Aplikues
48.	Ojq A.R.SH.K		Aplikues
49.	Ojq Mitrosport		Aplikues
50.	Ojq Horiz. E Gjelberta		Aplikues
51.	Ojq A.P.R.F.K		Aplikues
52.	Ojq Shekulli		Aplikues
53.	Daun Syndrome Kosova		Aplikues

Thirrja e dyte ende nuk është anuluar zyrtarisht, por me rregulloren ne fuqi 04-2017 i ka kaluar te gjitha afat ligjore.

9.Gjate kësaj periudhe raportuese janë realizuar shume vizita veç e veç neper klube sportive me ç‘rast është biseduar lidhur me organizimin e tyre dhe problemet me te cilat ballafaqohen ndërsa gjate kësaj periudhe është mbajtur edhe një takim i përbashkët me te gjitha klubet sportive ne kuadër te dëgjimit publik lidhur me buxhetin. -

Përveç këtyre punëve dhe detyrave të kryera, gjatë periudhës së një vjetarë të parë të vitit 2025, normalisht është punuar edhe në kryerjen e punëve dhe detyrave të përditshme dhe të obliguara me përshkrimin e punëve dhe detyrave të vendit të punës, edhe atë:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve
- Rregullimi dhe arkivimi i lëndëve
- Regjistrimi i klubeve dhe shoqatave
- Vizita klubeve dhe shoqatave sportive
- Vizita objekteve sportive
- Takimi me klube dhe shoqata sportive
- Takimet e rregullta në kuadër te DKRS-së
- Raportet javore ,tre , mujore, gjashtë mujore dhe vjetore
- Monitorimi i aktiviteteve sportive

9. Turnirët për 28 nëntorin dhe turniri për fund vite te cilën kane qene te planifikuar për vitin 2025 janë shtyje për janar te vitit 2026.

10. Sportistit i vitit dhe Çmimi “Lah Nimani “ për vitin 2025 ende nuk janë realizuar

Me respekt,

Gazmend Asllani

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport

